



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); web-site [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 54/12 Prot.

Tiranë, më, 12.06.2018

**V E N D I M**

**Nr. 48, datë 12.06.2018**

**PËR  
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KUÇOVË DHE 2-ISH KOMUNAT  
LUMAS DHE KOZARE, MBI RREGULLSHMËRISË  
E AKTIVITETIN EKONOMIK.**

**Për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017 për Bashkinë Kuçovë dhe nga data 01.01.2013 deri më datën 31.07.2015 për 2 ish-Komunat Lumas dhe Kozare.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr .154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit rregullshmërisë financiare të ushtruar në “Bashkinë Kuçovë dhe 2 ish Komunat Lumas dhe Kozare”, sipas programit të auditimit nr. 54/1,Prot., datë 18.01.2018,ndryshuar me shkresën nr.54/2, Prot., datë 26.02.2018 dhe shkresën nr. 54/3 Prot.,datë 19.03.2018, për veprimtarinë e Bashkisë Kuçovë për periudhën nga data 01.01.2016 deri më 31.12.2017 dhe 2 ish- komunat për periudhën 01.01.2013 deri më datën 31.07.2015.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

**A.MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:**

-Nga Drejtorët, Përgjegjëset e zyrës taksave dhe inspektorët e taksave edhe pse janë nxjerr listat e debitorëve dhe janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë, nuk janë kryer rakordime ndërmjet Drejtorisë Financës dhe Drejtorisë së Taksave. Për pasojë më datën 31.12.2017 ka një mos rakordim për më tepër në total në vlerën 14,820,840 lekë, pasi

kontabiliteti pasqyron debitorë në vlerën 78,155,673 lekë, ndërsa inventarizimi i debitorëve faktik me lista paraqitet në shumën 63,334,833 lekë. Kjo ka ardhur pasi nuk është kryer rakordim periodik dhe nuk janë hapur analizat (partitarët), në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe pikën 3, të Udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, Kreu III, paragrafi “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”.

-Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH-së, gjatë periudhës së auditimit, u nxorën dhe rakorduan të dhënat e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore për periudhën nga viti 2012 deri më datën 31.12.2017, për taksat e papaguara: nga bizneset, taksa e tokës, qiraja e tokave bujqësore shtetërore të pandara, respektivisht për Bashkinë Kuçovë dhe 3 ish-komunat, aktualisht Njësitë Administrative: Kozare, Lumas dhe Perondi. Nga ky rakordim rezultoi se nga mos ndjekja e procedurave të nevojshme ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është krijuar një e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën **63,335,269 lekë** (pa përfshirë këtu vlerën e taksave/tarifave vendore të papaguara nga popullata e Qytetit Kuçovë si, tarifatat për banesat, pastrimin, ndriçimin etj, për të cilën nga Drejtoria e Taksave nuk njihet gjendja pasi që 4 vjet nuk është bërë rakordim me Agjentin Tatimor Ujësjellësi Berat-Kuçovë SHA (sipas Anekseve nga numri 1 deri 4 të cilat ndodhen në Drejtorinë e Taksave Bashkia Kuçovë).

-Bashkia Kuçovë bazuar në nenin 5, shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, për arkëtimin e taksave vendore që në vitin 2012 ka lidhur Akt marrëveshje me Ujësjellësi Berat Kuçovë SHA, në cilësinë e Agjentit tatimor, por deri më datën 31.12.2017 që 3 vjet nuk ka kryer aktrakordime mujore dhe vjetore për tu njohur me listën dhe gjendjen e debitorëve të cilët nuk kanë paguar taksat, kjo kryesisht për familjarët (*Trajtuar nga faqja 144-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Kuçovë, të marrin masa për kryerjen e akt-rakordimeve për debitorët e taksave për periudhën 01.01.2012 deri më datën 31.12.2017 dhe pasqyrimin e saktë në kontabilitet të tyre në vlerën prej **63,335,269 lekë**, nga e cila:

- 304 subjekte biznesi në vlerën..... 14,059,432 lekë  
-3687 fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës në vlerën prej.....36,887,926 lekë  
- 264 qiramarrës nuk kanë paguar vlerën e qerasë të tokave prej .....12,387,731 lekë

Gjithsejtë:.....**63,335,269 lekë**

Sa sipër, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Taksave të nxirren njoftime vlerësimit tatimor dhe për arkëtimin e detyrimeve të mësipërme të ndiqen **rrugët e mëposhtme:**

**a) Tu ridërgohen bankave** urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Në rast mos kryerjes të urdhër bllokimeve prej bankave të njoftohet Guvernatori i Bankës Shqipërisë*).

**b) Ti ridërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit,** kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

c) **Për subjektet të cilët nuk** kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë “ të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014, datë 15.12.2014.

ç) **Në se edhe pas njoftimeve** zyrtare Bizneset nuk pranojnë në vite të paguajnë detyrimet, nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të Republikën e Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

d) **Drejtoria e Taksave** në Bashkinë Kuçovë të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët e 3 Njësive Administrative. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifatat etj (*Listat e debitorëve për Bashkinë Kuçovë dhe 3 Njësive Administrative gjenden pranë Drejtorisë të Ardhurave Bashkia Kuçovë, të printuara dhe në mënyrë elektronike (Anekset nr. 1,2 ,3, 4, 5 dhe 6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

e) **Drejtoria e Taksave** dhe Drejtoria e Financë Buxhetit, Bashkia Kuçovë, të marrin masa për rakordimin progresiv me Ujësjiellësin Berat-Kuçovë SHA, për ngarkesat dhe arkëtimin e taksave vendore që nga data e lidhjes së aktmarrëveshjes dhe në vazhdim të kryejë rakordime periodike. Për familjarët të cilët rezultojnë debitorë pasi sipas akt-marrëveshjes nuk kanë paguar taksat apo tarifatat tu dërgohen njoftim Vlerësimet tatimore nëpërmjet postës zyrtare. (*Trajtuar nga faqja 144-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

## **Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga 2-ish Komunat Lumas dhe Perondi për periudhën 2009-2013 u janë dhënë me qira 433 qiramarësve sipërfaqja prej 390 ha toka bujqësore shtetërore të pandara, me afat nga 10 deri 99 vjet, respektivisht: Njësia Administrative Lumas 187 ha me 181 kontrata dhe Perondi me 203 ha me 252 kontrata dhe pavarësisht punës së bërë se deri më datën 31.12.2017 ende nuk kanë paguar shumën 12,387,911 lekë.

Nga 2 ish-Komunat Lumas dhe Perondi pas reformës territoriale dhe bashkimin me Bashkinë Kuçovë, në asnjë rast për dhënien me qira për tokat shtetërore të pandara (pavarësisht se pjesa me e madhe sipërfaqes janë mbjelle me ullinj), nuk është bërë kontrolli i respektimit të kushteve të kontratës, në kundërshtim me pikën 5, shkronja (d) të Udhëzimit KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara” (*Trajtuar nga faqja 144-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

**2.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të ngrëjë një grup pune me pjesëmarrjen Drejtorisë së Taksave, Drejtorisë së Financës, Drejtorisë së Bujqësisë, Drejtorisë Juridike, Topografë, Njësive Administrative, etj., me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në 433 kontratat e lidhura për dhënien me qira në vite të tokave bujqësoret shtetërore të pandara, për sipërfaqen prej 390 ha. Krahas kësaj të kryhet edhe kontrolli i statusit juridik të tokave bujqësore të dhëna me qira (Pajisja me Certificate regjistrimi në Hipotekë, etj, në 3 Njësive Administrative të Bashkisë Kuçovë Lumas, Perondi dhe Kozare). Përveç sipërfaqes tokës së dhënë me qira, të verifikohen edhe rastet e zaptimit të

tokës, mbi sasinë e përcaktuar në kontratat dy paleshe apo zaptime toke pa asnjë lloj dokumentacioni.

#### **Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e Taksave, Policia Bashkiake dhe Drejtoria Juridike, nuk janë propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak paketa me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, mos veprime këto në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”, të ligjit nr.10.279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 144-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave, Policia Bashkiake dhe Drejtoria Juridike, të marrë masa për të paraqitur, propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, paketën me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative siç përcaktohet në kërkesat e nenit 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”, të ligjit nr.10.279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” .

#### **Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Kuçovë, sipas bilancit kontabël më datën 31.12.2017 ka fatura të palikuiduara nga 41 furnitorë në vlerën 147,775,359 lekë, të krijuara në vite përkatësisht;

Për vitin 2011 në vlerën 3,369,174 lekë; vitin 2015 në vlerën 5,087,088 lekë; vitin 2016 për vlerën 396,866 lekë; vitin 2017 në vlerën 138,922,231 lekë, ku për këtë vit detyrimet më të larta për vlerën 89,243,496 lekë ose në 65 % të detyrimeve gjithsejtë janë për punime të kryera në investime në fund të vitit 2017, pa siguruar fondet e nevojshme (*Trajtuar më hollësisht në faqe 30 -66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandim:** Bashkia Kuçovë (Drejtoria Financë Buxhetit), bazuar në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91-*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën 147,775,359 lekë.

#### ***Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak***

**5.Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2 vjeçare për vitet 2016-2017 nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Kuçovë nuk është mbajtur regjistri i vendosjes së gjobave edhe pse janë vendosur 32 gjoba në vlerën 11,200,000 lekë, të cilat janë pasqyruar në kontabilitet por, pa shtuar kamat vonesat në vlerën 6,720,000 lekë, ku vlera duke shtuar edhe kamat vonesat arin në shumën 17,920,000 lekë, nga të cilat deri më datën 30.03.2018 kur u krye auditimi nuk është paguar asnjë gjobë duke **vepruar në kundërshtim me:**

**a)** nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, **përcaktohet se:** Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

**b)** nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në nenet, 9, 22 dhe 30 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Pas fillimit të auditimit me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH-së, në harkun kohor nga data 07.02.2018 deri 21.02.2018, për 13 gjoba të vendosura në vitin 2016, nga Kryeinspektori i IMTV dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike pas rreth 1 vit e 4 muaj me vonesë, u kërkua në Gjykatë shndrimi në titull ekzekutiv i vendimeve të kundërvajtjes në vlerën

11,200,000 lekë, në përputhje me nenin 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr.10279,datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”(Trajtuar më hollësisht në faqet 154 -162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 -Rekomandim:** Bashkia Kuçovë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masa dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme të cilave u ka kaluar afati ligjor 2 vjeçar të vendosura për periudhën 2016-2017 në vlerën 11,200,000 lekë, duke shtuar në kërkesat drejtuar Gjykatës edhe llogaritjen e kamat vonesave në vlerën 6,720,000 lekë ose gjithsejtë në shumën 17,920,000 lekë.

Njëherazi të marrë masa për kthimin edhe të 19 vendimeve të gjobave të mbetura, për tu kthyer në tituj ekzekutiv, në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (Sipas Pasqyrës që administron IMTV Bashkia Kuçovë).

### Menjëherë

**6. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2016-2017 në subjektet private janë dhënë 32 Lejë ndërtimi, dhe po kaq me fondet shtetërore, ndërkohë nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë Kuçovë nuk janë hapur dosje për secilin subjekt, nuk ka marë zyrtarisht nga subjektet ndërtuese dokumentacionin teknik-ligjor dhe nuk ka pajisur zbatuesin e punimeve (subjektet ndërtuese) me vërtetim për likuidimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.2014” Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me ligjin nr. 10,324, datë 23.09.2010.

Nga 32 persona të pajisur me lejë ndërtimi, nuk është zbatuar grafiku i përfundimit të objekteve, pasi në asnjë rast nuk është dorëzuar objekti në afat dhe nuk është hartuar akt kolaudimi i objekteve,ndërkohë për këto raste nga IMTV nuk janë zbatuar sanksione për dënim me gjobë apo anulimin e lejeve të ndërtimit, siç parashikohet në ligjin nr. 107/2014 datë 01.10.2014 i ndryshuar, neni 52 -Kundërvajtjet administrative shkronja (dh)(Trajtuar më hollësisht në faqet 154 -162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandim:** Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë Kuçovë të meren masa që për 32 Lejë ndërtimi në subjekte private dhe objektet me fondet shtetërore të dhëna nga Bashkia për 2 vitet 2016-2017 dhe në vazhdim, të hapen dosje për secilin subjekt duke marrë zyrtarisht nga subjektet ndërtuese dokumentacionin teknik-ligjor dhe të pajisin zbatuesin e punimeve (subjektet ndërtuese) me vërtetim për likuidimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur, në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.2014”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me ligjin nr. 10,324, datë 23.09.2010.

Nga ana e IMTV Bashkia Kuçovë të ushtrohet kontroll për përfundimin e objekteve për 32 Subjektet e pajisura me lejë ndërtimi për 2 vitet 2016-2017 dhe në rastet kur nuk është zbatuar grafiku i fillimit apo përfundimit të punimeve të objekteve, të vendosen sanksione dënim me gjobë apo anulimin e lejeve të ndërtimit, siç parashikohet në ligjin nr. 107/2014 datë 01.10.2014 i ndryshuar, neni 52 -Kundërvajtjet administrative shkronja (dh) ku parashikohet se: Shkelja e afatit të fillimit punimeve apo përfundimit të punimeve , sipas nenit 40 të këtij ligji dënohen me gjobë nga 50,000-150,000 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqe 167-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### Menjëherë

**7. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit të Bashkisë Kuçovë, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, për objektet që legalizohen. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2015 deri më 31.12.2017 rezulton se Drejtoria e Planifikimit të Territorit në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje nuk e njihte gjendjen dhe nuk bëri të mundur nxjerrjen e listave për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga personat përgjegjës nuk është bërë asnjë punë për rakordimet me Drejtorinë Rajonale të ALUZNIT Berat dhe ZVRPP Kuçovë për bllokimin e veprimtarisë ligjore në regjistrimin e objekteve, për mos shlyerjen e detyrimeve ndaj Bashkisë Kuçovë së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 (*Trajtuar në faqen 167 -172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të ALUZNIT Berat dhe ZVRPP Kuçovë, të marrë masa për rakordimin dhe nxjerrjen e listave për numrin e personave të pajisur me leje legalizimi të cilat i disponon Bashkia Kuçovë.

**8. Gjetje nga auditimi.** Në auditimin e kryer për administrimin e aseteve në Bashkinë Kuçovë, u konstatua se ky proces nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e nenin 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, për shkak të mos funksionalitetit të zyrës së menaxhimit të aseteve (për prona publike, objekte, toka, troje, rrugë, pyje, kullota, etj.), në kundërshtim me: kreu II nenin 6, kreu III nenin 13 pikat a, b, c të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, kreu II organizimi, Neni 6 Për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës. Strukturë e cila duhet të realizonte administrimin dhe menaxhimin e aseteve për marrjen në dorëzim dhe zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV<sup>ve</sup>, për vënien në eficientë të ndërtesave të zaptuara me sipërfaqe gjithsej **21,984 m<sup>2</sup> dhe trull me sipërfaqe 51,239 m<sup>2</sup>** për plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave të munguara nga mos dhënia me qira e tyre (*Trajtuar më hollësisht në faqe 162 - 167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1.Rekomandimi:** Bashkia Kuçovë të marrë masa për ngritjen e zyrës për administrimin dhe mbrojtjen e tokës (ZAMT) siç përcaktohet në kreu II nenin 6, kreu III nenin 13 pikat a, b, c të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, kreu II organizimi, Neni 6 Për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës dhe vënien në eficientë të ndërtesave të zaptuara me sipërfaqe gjithsej **21,984 m<sup>2</sup> dhe trull me sipërfaqe 51,239 m<sup>2</sup>**.

**9. Gjetje nga auditimi:** Për të gjitha asetet e Bashkisë Kuçovë dhe 3 Njësitë administrative Lumas, Perondi dhe Kozare, nuk është hapur regjistri kontabël i aseteve, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia Kuçovë. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d, të Udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik (*Trajtuar më hollësisht në faqe 162 -167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1 Rekomandim:** Bashkia Kuçovë, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi sipas VKM respektive dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira, qofshin këto në formë truall të lirë, apo të pajisur me infrastrukturë .

#### Menjëherë

**10. Gjetje nga auditimi:** Në investimin me objekt “*Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas*” për të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes me OE “P██████” sh.p.k, sipas aktit me nr. 48, Prot., datë 20.03.2013, me vlerë të kontratës 9,634,354 lekë me TVSH, nga inspektimi në objekt i 10 banesave nga 22 në total, u konstatua se në çdo njërën prej tyre punimet ishin me mangësi si dhe me diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 762,481 lekë pa TVSH.

Gjithashtu u konstatuan se në shumë raste ka punime dhe procese apo zëra pune jo të përfunduara plotësisht duke u bërë shkak për praninë e lagështisë apo degradimin e ambienteve të banesave. Në dy raste u konstatua se volumet e punës për tualetet janë përlllogaritur një herë si volume pune së bashku me volumet e shtëpisë dhe një herë si volume pune sipas zërit “*Ndërtim ambient tualeti jashtë*”. Në disa raste dritaret ishin të pasilikonuara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 4, 7 dhe 12 , të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar, Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, pika 9 dhe Udhëzimin e KM nr. 1 datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë (*Trajtuar më hollësisht në faqe 125-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa, nëpërmjet një grupi specialistësh përkatës sipas nevojave të investimit, për verifikimin e objekteve të pa inspektuara në terren nga përfaqësuesit e KLSH-së, respektivisht objekt “*Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas*” dhe objektin “*Rikualifikim urban i lagjes 11 janari, Kuçovë*” me qëllim identifikimin si dhe arkëtimin e vlerës së punimeve për volumet e punës të likuiduara por të pakryera në fakt në 12 nga 22 banesat e pa inspektuara si dhe korrigjimin e mangësive të punimeve si pasojë e cilësisë së dobët të zbatimit në të gjitha banesat.

#### Menjëherë

**11. Gjetje nga auditimi:** KLSH ka ushtruar auditim për periudhën 2013-2015 dhe me shkresën nr. 32/6, datë 30.4.2015 ka adresuar gjetjet dhe rekomandimet në Bashkinë Kuçovë. Nga verifikimi rezultoi se deri më datën 30.03.2018, rekomandimet e dërguara nga KLSH me shkresën nr. 32/6, datë 30.04.2015, protokolluar në Bashkinë Kuçovë me nr. 51/48 dt. 06.05.2015 nga vlera e rekomanduar për masa shpërblim dëmi prej 24,941,331 lekë, është pranuar vlera 1,079,301 lekë e cila është kontabilizuar, deri më datën 16.03.2018 ishte

arkëtuar vlera prej 976,666 lekë, ndërkohë nuk është pranuar vlera prej 23,862,030 lekë. Për rekomandimet e pa zbatuara me vendimin e kryetarit të KLSH-së nr.32, datë 31.03.2016 përcjellë në Bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 1015/62 datë 05.04.2016, i është rikërkuar zbatimi i këtyre rekomandimeve z.S. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], kryetar i Bashkisë dalë pas zgjedhjeve të vitit 2015, por prej tij nuk është ndërmarrë asnjë veprim (*Trajtuar më hollësisht në faqet 7 -19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1Rekomandim:** Nga kryetari i Bashkisë Kuçovë të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin dhe arkëtimin e dëmit të shkaktuar Bashkisë Kuçovë për rekomandimet e lëna në auditin e mëparshëm dhe dërguar me shkresën e KLSH-së nr. 32/6, datë 30.04.2015, protokolluar në Bashkinë Kuçovë me nr. 51/48, datë 06.05.2015 të cilat nuk janë pranuar në 9 raste në vlerën prej 24,068,830 lekë, të analizuara në faqen 7-22 të *Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

## **B.MASA SHPËRBLIM DËMI DHE TË ARDHURA TË MUNGUARA ME DËM EKONOMIK.**

Bazuar në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b)-Të drejtat e KLSH- së, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e vlerës. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim arkëtimin e **vlerës 20,125,153 lekë**, nga e cila dëm ekonomik në vlerën **5,316,690 lekë** dhe të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën **14,808,463 lekë** si **më poshtë:**

### **B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

**1.Gjetje nga auditimi:**Nga verifikimi i saktësisë së pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit të dhëna për 2 vitet 2016-2017, rezulton se për 9 subjekte janë përlloritur më pak duke shkaktuar buxhetit të Bashkisë mungesë të ardhurash me **dëm ekonomik në vlerën 1,339,750 lekë**. Në kundërshtim me çmimet e përcaktuara në dy Udhëzimet e KM nr.4, datë 30.09.2015, “Për entin Kombëtar të Banesave për vitin 2015” dhe Udhëzimin e KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për entin Kombëtar të Banesave për vitin 2016”, nenin 46-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, të ligjit nr. 107/2014 datë 01.10.2014 i ndryshuar dhe nenin 27, të ligjit nr. 142/2015, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, date 30.10 2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 167 -172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandim:**Nga ana e Bashkisë Kuçovë, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit,të merren masa për arkëtimin e vlerës taksës së ndikimit në infrastrukturë të paguar më pak për 9 subjekte në vlerën **1,339,750 lekë** respektivisht:

A. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] në vlerën 1,181,059 lekë, S. [REDAKTUAR] M. [REDAKTUAR] në vlerën 19,311 lekë, G. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] në vlerën 24,640 lekë, I. [REDAKTUAR] M. [REDAKTUAR] në vlerën 9,262 lekë, L. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR] në vlerën 12,516 lekë, A. [REDAKTUAR] M. [REDAKTUAR] në vlerën 16,985 lekë, B. [REDAKTUAR] D. [REDAKTUAR] në vlerën 51,995 lekë, M. [REDAKTUAR] T. [REDAKTUAR] në vlerën 8,773 lekë dhe Shoqëria “A. [REDAKTUAR]” shpk në vlerën 15,209 lekë.

**Menjëherë**



**2.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Kuçovë me urdhër-shpenzimi nr.676, datë 04.10.2016 nëpërmjet Bankës për objektin “Rikonstruksionin e shkalleve të pikës turistike”, janë preventivuar dhe janë likuiduar në situacionet punime më tepër duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 69,000 lekë**, përfituar padrejtësisht BA operatorëve ekonomik “A [REDAKTUAR]” shpk+”S [REDAKTUAR]”(Trajtuar më hollësisht në faqe 30 -66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1Rekomandim:** Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **69,000 lekë**, BA operatorëve ekonomik “A [REDAKTUAR]” shpk+”S [REDAKTUAR]”, për likuidim nëpërmjet Bankës sipas urdhër-shpenzimit nr.676, datë 04.10.2016, të punimeve më tepër se situacioni i punimeve, në objektin “Rikonstruksionin e shkalleve të pikës turistike”.

#### Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e ish kryetarit të komunës Lumas z. Z [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] nëpërmjet procedurës për blerje të vogla është marrë me qira mjeti tip Tip Benz me targë AA [REDAKTUAR] AY për nevoja të administratës së komunës Lumas, duke lidhur kontratë me një person të palicencuar më organet tatimore në vlerën 115,000 lekë, respektivisht për vitin 2013 në vlerën 60,000 lekë/vit dhe vitin 2014 në vlerën 55,000 lekë/vit. Në fakt është paguar **vlera prej 70,000 lekë**, për vitin 2013 vlera 30,000 lekë dhe vitin 2014 për 40,000 lekë. Në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” dhe pikës 12 të nenit 3 të ligjit mësipërm, ku përcaktohet që: 12. Kontraktues, “furnizues” dhe “sipërmarrës i shërbimit” është çdo person fizik, juridik apo ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të tilla, që ofrojnë në treg si për marrjen e një ose disa punëve, furnizimin me mallra ose shërbime (Trajtuar më hollësisht në faqe 116 -120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandim:** Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **70,000 lekë** nga z. Z [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] ish kryetari i komunës Lumas si urdhërues për kryerjen e 2 procedurave të prokurimit në blerje të vogla për marrjen me qira për nevoja të komunës të mjetit tip Tip Benz me targë AA [REDAKTUAR] AY për vitet 2013-2014 duke lidhur kontratë me një person të palicencuar më organet tatimore.

#### Menjëherë

**4. Gjetje nga auditimi:** Përveç shkeljes së procedurës së prokurimit për marrjen me qera të mjetit tip Tip Benz me targë AA [REDAKTUAR] AY, për 2 vitet 2013-2014 janë tërhequr nga magazina 3800 litra naftë në vlerën **676,840 lekë**, ndërkohë magazinieri z. F [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] i cili ka qenë edhe drejtuesi i mjetit, në fletëdaljen e karburantit ka firmosur edhe si marrës i karburantit (pra ja ka bërë dalje vetes vet). Fletëdaljet nuk janë pajisur me urdhër dorëzimi nga ish kryetari i komunës dhe nuk janë prerë dhe mbyllur në fund të muajit por sipas hyrjes së mallrave. Gjithashtu nuk janë administruar tollonat e karburantit si letra me vlerë. Veprime në kundërshtim me pikat 36 dhe 38 të Udhëzimit Ministrit Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve të Njësisve të Sektorit Publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014 dhe udhëzimin nr.11, datë 06.05.2016, kreu III -Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre (Trajtuar më hollësisht në faqe 116 -120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandim:** Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **678,840 lekë** nga z. F [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] ish magazinier i ish komunës Lumas, i cili njëherazi ka qenë edhe drejtuesi i mjetit, Tip Benz me targë AA [REDAKTUAR] AY, pasi pa u pajisur me autorizim për furnizim me karburant nga ish kryetari i Komunës, në fletëdaljen e karburantit ka firmosur edhe si marrës i karburantit (pra ja ka bërë dalje karburantit vetes vet).

#### Menjëherë

**5. Gjetje nga auditimi:** Janë kryer pagesa për bonus transporti padrejtësisht për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012-2013-shkurt 2014 nga 15,000 lekë/muaj për z. **Z. S.** ish kryetar i komunës Lumas, në kundërshtim me ligjin nr. 169/2013, datë 7.11.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë",i ndryshuar me ligjin nr. 169/2013 miratuar më datë 07.11.2013, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 189,000 lekë** (konstatohet se z. **Z. S.** ish kryetar i komunës Lumas, *bonusin e transportit prej 15,000 lekë, për muajin tetor 2013 e ka marrë gabimisht 2 here, njëherë me urdhër shpenzimin nr. 121, datë 11.11.2013 për vlerën 15,000 lekë dhe përsëri me urdhër shpenzimin nr. 11, datë 05.02.2014 për vlerën 15,000 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqe 116 -120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandim:** Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **189,000 lekë** nga z. **Z. S.** ish kryetari i komunës Lumas për përfitimin padrejtësisht bonus transporti për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012 -2013-shkurt 2014 nga 15,000 lekë/muaj.

#### Menjëherë

**6. Gjetje nga auditimi:** Janë kryer pagesa për bonus transporti padrejtësisht për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012 -2013 nga 15,000 lekë/muaj për z. **M. H.**, ish kryetar i komunës Kozare, në kundërshtim me ligjin nr. 169/2013, datë 7.11.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë",i ndryshuar me ligjin nr. 169/2013 miratuar më datë 07.11.2013, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 180,000 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqe 120 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandim:** Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **180,000 lekë** nga z. **M. H.**, ish kryetar i komunës Kozar për përfitimin padrejtësisht bonus transporti për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012 -2013-shkurt 2014 nga 15,000 lekë/muaj.

#### Menjëherë

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt nga operator ekonomik “**P.**”, dëm ekonomik në vlerën **1,189,730 lekë pa TVSH**, në 3 objektet **si më poshtë:**

**a. Vlerën 762,481 lekë pa TVSH**, në objektin “*Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas*”, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 48, prot. datë 20.03.2013 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE “**P.**”sh.p.k (Trajtuar më hollësisht në faqe 120 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**b. Vlerën 320,284 lekë pa TVSH**, në objektin “*Rikonstruksion i institucioneve arsimore*”, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3549, prot datë 28.10.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE “**P.**” sh.p.k. (Trajtuar më hollësisht në faqe 133-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**c. Vlerën 106,965 lekë pa TVSH**, në objektin “*Mirëmbajtjen e Varrezave Publike, Bashkia Kuçovë*”, për sa janë situacionuar më shumë se sa janë preventivuar 3 zëra punimesh , parashikuar në nenin 8.2 të Kontratës sipërmarrjes të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe operatorit ekonomik “**P.**” shpk, sipas kontratës nr. 1516, prot, datë 11.05.2016 me afat 5 vite deri në 11.05.2021 (Trajtuar më hollësisht në faqe 36-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kuçovë të merren masa për arkëtimin nga operatori ekonomik “P [REDAKTUAR]” për vlerën **1,189,730 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit, në 3 objektet si më poshtë:

a. për arkëtimin e vlerës *762,481 lekë pa TVSH*, nga operatori ekonomik “P [REDAKTUAR]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 48 prot datë 20.03.2013 me objekt “*Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas*”, Kuçovë .

b. për arkëtimin e vlerës *320,284 lekë pa TVSH*, nga operatori ekonomik “P [REDAKTUAR]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3549, datë 28.10.2016 me objekt “*Rikonstruksion i institucioneve arsimore*”, Kuçovë.

c. për arkëtimin e vlerës *106,965 lekë*, apo kryerjen e ndalesës, ndaj operatori ekonomik “P [REDAKTUAR]” shpk, sipas kontratës me nr.1516, datë 11.05.2016 me afat 5 vite deri në 11.05.2021 (*shumë e cila ende deri më datën 30.03.2017 nuk është likuiduar*)

#### Menjëherë

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt nga operator ekonomik “Z [REDAKTUAR]” dëm ekonomik në vlerën **365,885 lekë pa TVSH**, në 2 objektet **si më poshtë:**

a. Vlerën *157,710 lekë pa TVSH*, në objektin “*Rikonstruksioni i Rrugës Kongresi i Lushnjës*”, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3105, prot datë 21.09.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE “Z [REDAKTUAR]” sh.p.k. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 133-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

b. Vlerën *208,175 lekë pa TVSH*, në objektin “*Rehabilitim i pjesshëm Skema e Ujitjes Perondi*”, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2015 prot datë 22.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE “Z [REDAKTUAR]” sh.p.k. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 125 -144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kuçovë të merren masa për arkëtimin nga operatori ekonomik “Z [REDAKTUAR]” për vlerën **365,885 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit në **2 objektet si më poshtë:**

a. Vlerën *157,710 lekë pa TVSH*, nga OE “Z [REDAKTUAR]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3105, datë 21.09.2016 me objekt “*Rikonstruksioni i Rrugës Kongresi i Lushnjës*”, Kuçovë.

b. Vlerën *208,175 lekë pa TVSH*, nga OE “Z [REDAKTUAR]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2015, datë 22.06.2016, në objektin “*Rehabilitim i pjesshëm Skema e Ujitjes Perondi*”, Kuçovë.

#### Menjëherë

**9. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “*Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike*”, Kuçovë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **363,920 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2557, prot datë 02.08.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe BOE “A [REDAKTUAR]” sh.p.k dhe “S [REDAKTUAR]” sh.p.k. (*Trajtuar në faqe 125 -144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kuçovë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **363,920 lekë pa TVSH** nga BOE “A [REDAKTUAR]” sh.p.k dhe “S [REDAKTUAR]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2557 Prot., datë 02.08.2016 me objekt “*Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike*”, Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

**Menjëherë**

**10.Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të bankës së ish Komunën Lumas, rezulton se sipas situacionit përfundimtar vjetor urdhër shpenzimin nr. 137,dt.03.12.2013 Fatura tatimore nr.09835273 datë 02.12.2013 urdhër shpenzimin nr. 74,dt.28.05.2015, në vleftën e situacionit përfundimtar është shtuar dhe financuar zëri i punimeve Hartim projekti+ preventiv zbatimi + projekt ide 2.5 është, pa u mbështetur në dispozitë ligjore apo nënligjore duke i likuiduar padrejtësisht më tepër edhe vlerën 872,565 dëm ekonomik pa TVSH. Akt kolaudimi datë 10.02.2015 objekti është realizuar më dt. 24.01.2015. Sipërmarrësi T [REDAKTUAR] dhe B [REDAKTUAR] shpk, mbikqyrës i punimeve Z [REDAKTUAR] shpk Ing. R [REDAKTUAR] T [REDAKTUAR] me NUIS K [REDAKTUAR] dhe kolaudatore Ing.L [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR]. Akt dorëzimi dt. 18.02.2015 nënshkruar nga ish kryetari i komunës Lumas z. Z [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] dhe marësve në dorëzim: B [REDAKTUAR] C [REDAKTUAR], K [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] dhe A [REDAKTUAR] Q [REDAKTUAR].

Në hartimin e Preventivit dhe Situacionit Përfundimtar të punimeve për objektin: Sistemim-Asfaltimi i Rrugës Fshatit Shqez-Vodez-Koritez Faza e parë Komuna Lumas nuk është mbajtur parasysh Modelit TIP i hartimit (**Preventivit dhe Situacionit**), përcaktuar në pikat 3. 3.1-Preventivat... dhe 3.3-Situacionet,të Udhëzimit KM nr. 01, datë16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e KM nr. 03, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

**10.1.Rekomandim:** Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të merren masa për arkëtimin e **vlerës 872,565 lekë pa TVSH**, nga Shoqëria “T [REDAKTUAR]” dhe “B [REDAKTUAR]” Sh.p.k, pasi kjo vlerë është shtuar në preventivin e punimeve, të objektit: Sistemim-Asfaltimi i Rrugës Fshatit Sheqez-Vodez-Koritez Faza e I-rë, pa u mbështetur në dispozitë ligjore apo nënligjore dhe financuar padrejtësisht zëri i punimeve Hartim projekti+ preventiv zbatimi + projekt ide në masën 2.5 % mbi vlerën e preventivit 34,902,600 lekë.

**Menjëherë**

**B.2.TË ARDHURA TË MUNGUARA ME DËM EKONOMIK në vlerën 14,808,463 lekë, si më poshtë:**

**10.1. Gjetje nga auditimi:** Nga 2-ish Komunat Lumas dhe Perondi për periudhën 2009-2013 u janë dhënë me qira 433 qiramarrësve toka bujqësore shtetërore të pandara për sipërfaqen prej 390 ha, me afat nga 10 deri 99 vjet, respektivisht: Njësia Administrative Lumas 187 ha për 181 kontrata dhe Perondi me 203 ha për 252 kontrata. Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH-së, gjatë periudhës së auditimit, u nxorën dhe rakorduan të dhënat për periudhën nga viti 2012 deri më datën 31.12.2017 për qiranë e tokave të pandara, respektivisht për 2 ish-komunat, aktualisht Njësitë Administrative, Lumas dhe Perondi, dhe rezultoi se **277 qiramarrës nuk kanë** paguar vlerën e qerasë për të cilën u kërkua llogaritja e kamat vonesave si e ardhur e munguar me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën prej **12,387,911 lekë sipas Anekset nga numri 1 deri 4 (Trajtuar më hollësisht në faqe 144 -152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Nga 2 ish-Komunat Lumas dhe Perondi pas reformës territoriale dhe bashkimin me Bashkinë Kuçovë, në asnjë rast për dhënien me qira për tokat shtetërore të pandara (pavarësisht se pjesa me e madhe sipërfaqes janë mbjelle me ullinj),nuk është bërë kontrolli i respektimit të kushteve të kontratës, në kundërshtim me pikën 5, shkronja (d) të Udhëzimit

KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara” (Trajtuar nga faqja 144-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandim:** Drejtoria e Taksave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Kuçovë të marrin masa për njoftimin e 277 Fermerëve të cilat nuk kanë paguar vlerën e qirasë dhe kamat-vonesave në masën 1% në ditë të cilat janë parashikuar në kontratat e lidhura ndërmjet palëve gjatë periudhës 2009-2013 për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara për vlerën **12,387,911 lekë**.

-Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të ngrejë një grup pune me pjesëmarrjen Drejtorisë së Taksave, Drejtorisë së Financës, Drejtorisë së Bujqësisë, Drejtorisë Juridike, Topografë, Njësive Administrative, etj., me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në 433 kontratat e lidhura për dhënien me qira në vite të tokave bujqësoret shtetërore të pandara, për sipërfaqen prej 390 ha. Krahas kësaj të kryhet edhe kontrolli i statusit juridik të tokave bujqësore të dhëna me qira (Pajisja me Certificate regjistrimi në Hipotekë, etj, në 3 Njësiti Administrative të Bashkisë Kuçovë Lumas, Perondi dhe Kozare).Përveç sipërfaqes tokës së dhënë me qira, të verifikohen edhe rastet e zaptimit të tokës, mbi sasinë e përcaktuar në kontratat dy paleshe apo zaptime toke pa asnjë lloj dokumentacioni.

**Menjëherë**

### **11.2.Gjetje nga auditimi:**

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Financës rezulton se nga IMTV Kuçovë nga vitet e mëparshme janë vendosur 8 gjoba vlera e të cilave janë pasqyruar në kontabilitet në shumën prej **2,401,052 lekë**, (pa vlerën e kamat vonesave), por edhe pse kanë kaluar mbi 2 vjet nga data e vendosjes tyre, nuk kanë filluar procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e tyre, në kundërshtim me nenin 46, të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”. Nga shuma e 8 vendimeve të gjobave të vendosura në vite dhe të pa arkëtuara deri më datën 16.03.2018 në vlerën 2,401,052 lekë , analizohen si më poshtë:

a-Për 2 vendime gjobash në vlerën 367,348 lekë pretendohet se janë kthyer në tituj ekzekutiv nga gjykata, në vitin 2012 (por nuk gjenden vendimet e gjykatës) , pra deri më datën 30.03.2018 edhe pse kanë kaluar 7.5 vjet ende nuk janë ekzekutuar.

b-Për 2 vendime gjobash në vlerën 600,000 lekë janë kthyer në tituj ekzekutiv nga gjykata në vitin 2012 por deri më datën 30.03.2018 edhe pse kanë kaluar 7.5 vjet ende nuk janë ekzekutuar.

c-Për 4 vendime gjobash në vlerën 1,400,000 lekë, nga gjykata në vitin 2014 janë kthyer në tituj ekzekutiv, por deri më datën 30.03.2018 edhe pse kanë kaluar 5 vjet ende nuk janë ekzekutuar. Në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996,”Kodi i Procedurës Civile në RSH “ i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja (ç) ku përcaktohet se: Vënia në ekzekutim e urdhrorit të ekzekutimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kreditorit (Trajtuar më hollësisht në faqet 154 -162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.2.1 Rekomandimi:** Bashkia Kuçovë Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike,bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme,të vendosura për periudhën 2009-2015 **në vlerën 2,401,052 lekë**, (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar) Njëherazi të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (*Sipas Pasqyrës që administron IMTV Bashkia Kuçovë*).

**Menjëherë**

**12.3.Gjetje nga auditimi:** Në 5 raste është paguar qytetari B [ ] A [ ] nëpërmjet xhirimit në numrin e llogarisë për shpenzime për qiranë e shkollës Bardhaj sipas kontratës nr. prot ska datë 13.02.2013 me vlerë 40,000 lekë. Urdhëruesi ish kryetari i Komunës Lumas z. Z [ ] S [ ] dhe kontabilistja Përgjegjës e Degës financës znj.B [ ] D [ ]. Për këtë pagesë nuk është ndalur tatimi në burim në masën 15 %, në kundërshtim me nenin 33, pika 1, shkronja “P”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 19,500 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqe 116 - 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.3.1 Rekomandim:** Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **19,500 lekë** nga qytetari B [ ] A [ ], sa nuk ka paguar tatimin në burim për qiranë e shkollës Bardhaj sipas kontratës nr. prot ska datë 13.02.2013.

**Menjëherë**

**B/3. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA MË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHEPËR MENAXHIM ME EKONOMICITETE, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluara në Bashkinë Kuçovë, u konstatua se në 3 procedura, nga vendosja e gabuar e kriterëve të veçanta për kualifikim, në kundërshtim me LPP nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014, nenin 26, “Kontrata për punë publike”, në 3 procedura prokurimi janë s`kualifikuar e kualifikuar në mënyrë të gabuar, OE pjesëmarrës në garë, në një kohë që nga mungesa e konkurrencës procedurat duhet të anuloheshin, **duke shkaktuar rritje të kostos me efekt negativ në vlerën prej 4,695,117 lekë për buxhetin e Bashkisë.** Konkretisht në 3 procedurat e prokurimit të zhvilluara me objekt:

**1-Tenderi i zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Kongresi i Lushnjës, me fond limit 12,077,664 lekë, fituar nga “Z [ ]” shpk me vlerë 11,521,787 lekë, nga auditimi u konstatua se kërkesat për kualifikim janë të paargumentuara dhe në kundërshtim me nenin, 2 e 20 të LPP. Këto kërkesa kanë lidhje me përcaktimin e gabuar në lidhje me vërtetimin nga autoriteti kontraktor që nuk ka detyrime pranë Bashkisë Kuçovë, certikatë: siguria ushqimore mbi punonjesit 22000:2005, dokumentacionin argumentues të malinerisë teknologjike të tubove, etj. Disa nga kërkesat për kualifikim kanë ndryshuar gjatë zhvillimit të procedurës, në një kohë që procedura duhej të anulohet dhe rihapej. Nga auditimi i vlerësimit të ofertave rezultoi se KVO ka vepruar me dy standarde në vlerësimin e ofertave, pasi edhe për të njëjtat arsye është s`kualifikuar OE me vlerë më të ulët, duke shkaktuar **efekt negativ ekonomik në shumën 1,051,490 lekë. Kjo procedurë në kushtet kur asnjëri prej ofertuesve nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim, procedura duhej të anulohet, bazuar në nenin 46/1 dhe 53 /3 të LPP, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi KVO.****

**2 -Tender i zhvilluar me objekt: “Rikonstruksion i zyrës së Kryetarit të Bashkisë Kuçovë”, me fond limit 1,053,258, fituar nga “Dhjonis” shpk, me vlerë 996,664 lekë, rezultoi se: nuk janë argumentuar kërkesat për kualifikim, në drejtim të vërtetimit për shlyerjen e taksave vendore, vërtetimit të punëve të ngjashme.**

U konstatua se janë ndryshuar kërkesat për kualifikim gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, **në lidhje me xhiron mesatare vjetore 2016, ku kjo mesatare vlen nga janari deri tetor 2016 dhe në një kohë që kjo procedurë duhej të anulohet.** Nga përcaktimi i gabuar i kërkesave të veçanta për kualifikim nga ana e NJHDT, është shkaktuar efekt negativ financiar në shumën **205,684 lekë**, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi NJHDT bazuar në nenin 42 të

LPP dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 14, “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët”, neni 62, “Ndryshimi i dokumenteve të tenderit”, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi NJHDT.

**3-Tender i zhvilluar me objekt: “Rikonstruksioni i sheshit dhe fushave tek shkollat “Gaqi Karakashi” dhe “28 Nëntori”, me fond limit 18,593,109 lekë, fituar nga “Z[REDACTED]” shpk me vlerë 18,303,173 lekë.**

**Nga auditimi i konstatua se:** për kërkesat për kualifikim janë vënë në mënyrë të paargumentuar kërkesat për kategoritë e licencës, vërtetimi i taksave vendore është kërkuar për 4 vjet, janë kërkuar që në stafin drejtues të kenë 2 inxhinier te kualifikuar me ISO BS OH SAS 18001:2007 për sistemin e menaxhimit të sigurisë në kantier të cilët duhet të gjenden edhe licence, në një kohë që kjo licencë jepet për kompani dhe jo individë, janë kërkuar arkeolog e gjeolog në kundërshtim me preventivin e punimeve, si dhe kërkesa të fryra në lidhje me makinerinë e prodhimit të betonit,

Si rezultat i vendosjes së kriterëve të gabuara nga ana e NJHDT dhe vlerësimit të gabuar të KVO dhe KSHA, është shkaktuar efekt negativ financiar në shumën **3,437,943 lekë. Kjo procedurë duhej të anulohet pasi asnjë operator ekonomik nuk është i vlefshëm në procedurë, bazuar në nenin 46/1 dhe 53 /3 të LPP**

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 66-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandim:** Bashkia Kuçovë, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/e shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ në buxhetin e bashkisë për vlerën **4,695,117 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

## **C. MASA ADMINISTRATIVE:**

### **C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)**

I. Referuar parregullsi dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **14 punonjësve**, për procedurat e prokurimit, si më poshtë:

#### **I. Bashkia Kuçovë, për 8 punonjës si më poshtë:**

**1.L[REDACTED] K[REDACTED], NJHD në cilësinë e anëtares së NJHDT, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve Publike, në 5 procedurat:**

- a. “Rehabilitim i pjesshëm “Skema e ujitjes Perondi” dhe “Skema e ujitjes Kozare”
- b. “Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike, Kuçovë”
- c. “Rikonstruksioni i rrugës Kongresi i Lushnjës”
- d. “Rikonstruksion i institucioneve arsimore Kuçovë”
- e. “Rikonstruksioni i sheshit dhe fushave tek shkollat “Gaqi Karakashi” dhe “28 Nëntori”,

**2.F[REDACTED] P[REDACTED], NJHDT me detyrë Drejtor i Planifikimit Urban, në 5 procedurat**

- a. "Rehabilitim i pjesshëm "Skema e ujitjes Perondi" dhe "Skema e ujitjes Kozare"
- b. "Rikonstruksioni i rrugës Kongresi i Lushnjës"
- c. "Rikonstruksion i zyrës së Kryetarit të Bashkisë Kuçovë"
- d. "Rikonstruksion i institucioneve arsimore Kuçovë"
- e. "Rikualifikim urban i lagjes 11 janari"

**Ne KVO**

- f. "Rikonstruksioni i sheshit dhe fushave tek shkollat "Gaqi Karakashi" dhe "28 Nëntori",

**3.E ■■■■ M ■■■■, NJHDT, me detyrë ish specialit i planifikimit të territorit, në 5 procedurat**

- a. "Rikonstruksioni i rrugës Kongresi i Lushnjës"
- b. "Rikonstruksion i zyrës së Kryetarit të Bashkisë Kuçovë"
- c. "Rikonstruksioni i sheshit dhe fushave tek shkollat "Gaqi Karakashi" dhe "28 Nëntori",
- d. "Rikonstruksioni i sheshit dhe fushave tek shkollat "Gaqi Karakashi" dhe "28 Nëntori",
- e. "Rikualifikim urban i lagjes 11 janari"

**4.Sh ■■■■ N ■■■■, anëtar i KVO , me detyrë Nënkyetar i Bashkisë, në 4 procedurat**

- a. "Rehabilitim i pjesshëm "Skema e ujitjes Perondi" dhe "Skema e ujitjes Kozare"
- b. "Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike, Kuçovë"
- c. "Rikonstruksioni i rrugës Kongresi i Lushnjës"
- d. "Rikonstruksion i institucioneve arsimore Kuçovë"

**5.A ■■■■ C ■■■■, anëtare KVO , me detyrë specialist finance në 2, procedurat**

- a. "Rehabilitim i pjesshëm "Skema e ujitjes Perondi" dhe "Skema e ujitjes Kozare"
- b. "Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike, Kuçovë"

**6.J ■■■■ L ■■■■, anëtar KVO , me detyrë specialist i IMT, në 5 procedurat**

- a. "Rehabilitim i pjesshëm "Skema e ujitjes Perondi" dhe "Skema e ujitjes Kozare"
- b. "Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike, Kuçovë"
- c. "Rikonstruksioni i rrugës Kongresi i Lushnjës"
- d. "Rikonstruksion i institucioneve arsimore Kuçovë"
- e. "Rikonstruksioni i sheshit dhe fushave tek shkollat "Gaqi Karakashi" dhe "28 Nëntori",

**7.Y ■■■■ Zh ■■■■, KVO, me detyrë Drejtor i Zhvillimit Rural, në 3 procedurat**

- a. "Rikonstruksioni i rrugës Kongresi i Lushnjës"
- b. "Rikonstruksion i institucioneve arsimore Kuçovë"
- c. "Rikonstruksioni i sheshit dhe fushave tek shkollat "Gaqi Karakashi" dhe "28 Nëntori",

**8.E ■■■■ A ■■■■ NJHDT, me detyrë specialist e planifikim territorit, në 4 procedurat**

- a. "Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike, Kuçovë"
- b. "Rikonstruksion i zyrës së Kryetarit të Bashkisë Kuçovë"
- c. "Rikonstruksion i institucioneve arsimore Kuçovë"
- d. "Rikualifikim urban i lagjes 11 janari"

*(Trajtuar më hollësisht në faqe 66 -116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**II.Ish komuna Lumas**

**9. 1 z.B ■■■■ C ■■■■, ish teknik ndërtimi , anëtar i KVO**

**10.2.znj. B ■■■■ D ■■■■ , ish Përgjegjëse e zyrës financës, anëtare KVO**

**11.3.z. F ■■■■ K ■■■■, specialist i bujqësisë, anëtar i KVO**

**Për shkeljet në 2 procedurat e prokurimit si më poshtë;**



1. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i shkollës fillore fshati Bardhaj”, Lloji i Procedurës-“Kërkesë për propozim” tenderi i zhvilluar më datë 10.05.2013, me kontratë nr.323, prot datë 3.6.2013 me vlerë 6,653,000 lekë. Tenderi duhej të ishte anuluar për mungesë konkurrence.

2.Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Rikonstruksion** i rrugës Sheqes- Vodes- Korites (faza e parë)”, Lloji i Procedurës-“Kërkesë për propozim” zhvilluar tenderi më datë.26.03.2013, me kontratë nr.ska,prot dt. 3.6.2013 me vlerë 37,433,410 lekë. Tenderi duhej të ishte anuluar për mungesë konkurrence.

(Trajtuar më hollësisht në faqe 116 -120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **III. ish komuna Kozare**

**12.1.znj. V L kryetar**, specialiste bujqësie anëtare KVO

**13.2.z. S M**,ish specialist anëtare KVO

**14.3.z. E Gj**, ish specialist, anëtare KVO

*Për shkeljet në 2 procedurat e prokurimit si më poshtë:*

1. Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje autoveture**”, Lloji i Procedurës –“Hapur” zhvilluar tenderi më datë.15.04.2014, me kontratë nr.ska,prot dt. 08.05.2013 me vlerë 990,000, lekë pa TVSH. Mangësitë e konstatuara përbëjnë kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik konkurrent.

2. Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Ndërtim i shkollës fillore Frashër**”,Lloji i Procedurës –“Hapur ” zhvilluar tenderi më datë.24.05.2013, me kontratë nr.ska,prot me vlerë 5,331,407 lekë. Mangësitë e konstatuara përbëjnë kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik konkurrent.

### **C.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMTV) Bashkia Kuçovë.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenet 7 dhe 12 , Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimi e KM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe shpjegimet dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Kuçovë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 3 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh, si më poshtë:

1.V T, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:

a. “Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas”, me vlerë të kontratës së punimeve në vlerën 9,634,354 lekë me TVSH, me sipërmarrës punimesh OE “P” sh.p.k dhe me pasojë dëm ekonomik në vlerën **762,481 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;

2.E M, përfaqësues ligjor i subjektit “A” sh.p.k, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet:

a. “Rikonstruksioni i Rrugës Kongresi i Lushnjës”, me vlerë të kontratës së punimeve në vlerën 11,521,787 lekë me TVSH, me sipërmarrës punimesh OE “Z” sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **157,710 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;

b. "Rikonstruksion i institucioneve arsimore", me vlerë të kontratës së punimeve në vlerën 6,254,346 lekë me TVSH, me sipërmarrës punimesh OE "Z██████" sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **157,710 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;

**3.F██████ B██████**, përfaqësues ligjor i subjektit "H██████" sh.p.k, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet:

a. "Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike", me vlerë të kontratës së punimeve në vlerën 7,588,000 lekë me TVSH, me sipërmarrës punimesh BOE "A██████ & S██████" sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **363,920 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;

b. "Rehabilitim i pjesshëm Skema e Ujitjes Perondi, Kuçovë", me vlerë të kontratës së punimeve në vlerën 24,562,881 lekë me TVSH, me sipërmarrës punimesh OE "Z██████" sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **208,175 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;

**4.L██████ V██████**, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e kolaudatores së punimeve në objektin:a. "Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas", me vlerë të kontratës së punimeve në vlerën 9,634,354 lekë me TVSH, me sipërmarrës punimesh OE "P██████" sh.p.k dhe me pasojë dëm ekonomik në vlerën **762,481 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;  
(Trajtuar më hollësisht në faqe 125-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

## **D. MASA DISIPLINORE:**

### **D. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, shkronja (b) "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmartjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i **rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Kuçovë, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **për 2 punonjësit si më poshtë:**

**a-"Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj"** e parashikuar në nenin 58, shkronja "b" **për 2 punonjësit** si më poshtë:

**1.M██████ F██████**, me detyrë Drejtore e Burimeve Njerëzore

-Me vënien në dijeni për masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH, me shkresën nr. 32/6, datë 30.04.2015 dhe përsëritura rekomandimet e pa zbatuara me vendimin e kryetarit të KLSH nr.32, datë 31.03.2016 përcjellë në Bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 1015/62 datë 05.04.2016 rikërkim i zbatimit të rekomandimeve **u konstatua se:**

-Nuk i ka kërkuar titullarit krijimin e Komisionit Disiplinor (KD), në kundërshtim me pikën 3, Kreu I-Organet Disiplinore të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin civil",

-Nuk i ka klasifikuar ato sipas nenit 57, të ligjit për Nëpunësin Civil dhe nuk ja ka përcjellë masat disiplinore Komisionit Disiplinor, sipas nenit 59 për Nëpunësin Civil dhe pikave 7, 9 dhe 10 të VKM nr. 115, datë 05.03.2014 dhe në cilësinë e Eprorit direkt,

- Me vënien në dijeni për masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH, në kundërshtim me VKM nr.115, datë 05.03.2014”Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarjen në Komisionin Disiplinor (KD) në shërbimin civil”, nuk ka ndërmarrë veprimet si më poshtë:

-Nuk i ka vlerësuar paraprakisht shkeljet disiplinore,në kundërshtim me Pikën 7,

-Nuk ka bërë klasifikimin e shkeljeve disiplinore, në kundërshtim me Pikën 9,

-Nuk ka kryer vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë në zbatim të VKM nr. 109, datë 26.02.2014” Për vlerësimin e rezultateve në punë të Nëpunësve Civilë”; ndryshuar me VKM nr. 252, datë 30.03.2016 ”Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, pika 12- Procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, shkronja (i) .

-Për tërheqjen e karburantit nga magazina për 2 vitet 2016-2017 për mjetet që disponon Bashkia Kuçovë, pa u pajisur me urdhër dorëzimi dhe pa nënshkruar Fletë daljet e magazinës duke qenë në detyrën e Drejtores Burimeve Njerëzore.

**2.Th N, ish Drejtor i Drejtorise të Ardhurave deri më datën 08.11.2016, aktualisht Drejtor i Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik.**

**Për shkeljet e mëposhtme:**

-Në mjaft raste kur janë trajtuar gjetjet dhe rekomandimet nuk janë shoqëruar me referencën ligjore përkatëse, neni, pika, VKM apo Ligje, për pasojë një pjesë e këtyre rekomandimeve janë ta paqarta dhe të pazbatueshme. Në trajtimet që u bëhet materialeve të auditimit si referencë ligjore nuk mbështetet në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë apo Institucionit që auditohet.

-Dosjet e auditimit në të gjitha rastet nuk janë plotësuar me letrat e punës, apo fotokopje të dokumentacionit mbështetës, argumentues, etj, si pasqyra të buxhetit, lista e objekteve të prokuruar, marja në dorëzim e materialeve apo punimeve të ndërtimit etj.

-Nga ana e Njesisë së Auditimit Publik Bashkia Kuçovë nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është mjaftuar vetëm me përgjigjen e subjekteve të audituara dhe nga disa subjekte nuk është kthyer asnjë përgjigje.

-Nga mbikqyrja e disa praktikave për auditimet e kryera në 3 ish komunat Kozare,Perondi dhe Lumas, u konstatua se materialet e auditimit të hartuara nuk janë cilësore dhe jo në përputhje me standartet e auditimit.

-Nga audituesit e Njesisë Auditimit të Brendshëm Publik, Bashkia Kuçovë, nuk njihet dhe për pasojë nuk është zbatuar Manuali i auditimit miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016”Për miratimi e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”,

-Në 4 auditimet e ushtruara gjatë vitit 2017 sipas programit vjetor të miratuar nga Kryetari i Bashkisë nuk është parashikuar dhe audituar zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” për pasojë 2 subjektet e audituara respektivisht:Drejtorinë e Shërbimeve Komunale dhe Qendrën Ekonomike të Arsimit, të cilat nuk e njohin fare ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (Pasi nuk kanë depozituar Raportet dhe vetëdeklarimet)

**-Për periudhën kur ka qënë ish Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave deri më datë 08.11.2016:**

-Nuk ka kryer rakordimin për taksat e banesave, tarifat e pastrimit, etj, taksa të popullatës, të cilat janë mbledhur nga Ujësjiellës Berat-Kuçovë SHA , në cilësinë e Agjentit Tatimor.

-Për mos ndjekje të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet debitor, në kundërshtim me kërkesat e Kreut XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

## **D. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 14-Masat disiplinore shkronja (b), **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë** fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

### **a. “Vërejtje me paralajmërim”, për 16 punonjësit e mëposhtëm:**

1. **znj. E [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR]**, ish-Specialiste kontabiliteti nga 21.10.2008 deri 08.11.2016, Drejtore e të ardhurave nga data 08.11.2016 deri 15.03.2017, Specialiste kontabiliteti nga data 16.3.2017 e në vazhdim.

2. **z.L [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR]**, Inspektor i kontrollit borxhit e koordinimit nga 01.07.2016 e në vazhdim, Inspektor i regjistrimit dhe shërbimit të biznesit nga data 11.03.2014 deri me datën 01.07.2016.

3. **z.D [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR]**, Inspektore e regjistrimit dhe procedurave ligjore nga data 17.02.2011 e në vazhdim.

4. **z.S [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR]**,Pergjegjes i agjencisë , inspektor i taksapaguesve Njesia administrative Kuçove nga data 16.6.2016 e ne vazhdim.

5. **z.T [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR]**, Agjent tatimor nga data 05.06.2017 e në vazhdim.

6. **z.Th [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR]**, Agjent tatimor Njësia Kuçove.

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

-Nga Drejtorët, përgjegjëset e zyrës taksave dhe inspektorët e taksave edhe pse janë nxjerr listat e debitorëve dhe janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë, nuk janë kryer rakordime ndërmjet Drejtorisë Financës dhe Drejtorisë Taksave,për pasojë më datën 31.12.2017 ka një mos rakordim më tepër në total në vlerën 14,820,840 lekë, pasi kontabiliteti pasqyron debitorë në vlerën 78,155,673 lekë, ndërsa inventarizimi i debitorëve faktik me lista paraqitet në shumën 63,334,833 lekë. Kjo ka ardhur pasi nuk është kryer rakordim periodik dhe nuk janë hapur analizat (partitarët), në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe pikën 3 të Udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011“ Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”.

-Për mos rakordimin për taksat e banesave, pastrimit, etj, të cilat janë mbledhur nga Agjenti Tatimor Ujësjetës Berat-Kuçovë SHA.

-Për mos ndjekje të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet debitor, në kundërshtim me kërkesat e Kreut XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor*, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë në **vlerën 63,335,269 lekë**, 304 subjekte biznesi në vlerën 14,059,432 lekë, 3687 fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës në vlerën 36,887,926 lekë, 264 qiramarrës nuk kanë paguar vlerën e qerasë të tokave prej 1,469,932 lekë.

-Për mos nxjerrje të njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920,datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 23.

-Për mos krijimin e regjistrimit për taksapaguesit familjar në Bashkinë Kuçovë, në kundërshtim me pikën 7, neni 4, të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Bazuar ne ligjin nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore “, neni 66-Detyrat e administratës së njësisë administrative, ku përcaktohet se : b.Mbikqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të

bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin, mbajnë përgjegjësi 3 administratorët e Njësive administrative dhe punonjësit e taksave si më poshtë :

7. z.K. ■■■■■ M. ■■■■■, Administrator i Njesisë Administrative Lumas nga 01.06.2017 e në vazhdim.

8. znj.E. ■■■■■ D. ■■■■■, Mbikqyrse (Inspektore taksapaguesve) në Njësine Administrative Lumas nga 01.04.2016 e në vazhdim.

Nga mos kryerja e detyrave funksionale Njësia Administrative **Lumas** më datën 28.02.2018 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar të ardhura të munguara në vlerën **10,344,949 lekë**, nga e cila 17 subjekte biznesi në vlerën 492,234 lekë, 815 fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës në vlerën 10,344,949 lekë, 50 persona nuk kanë paguar për 20 ha vlerën e tokës së pandarë të dhënë me qira në shumën 1,309,253 lekë. Nuk kanë njoftuar familjarët nëpërmjet postës, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

9. z.F. ■■■■■ B. ■■■■■ Administrator i Njesisë administrative Kozare nga 16.03.2017 e në vazhdim.

10.z.B. ■■■■■ S. ■■■■■ Inspektor i tatimpaguesve në Njesisë administrative Kozare nga 01.01.2014 e në vazhdim.

Nga mos kryerja e detyrave funksionale Njësia Administrative Njësia Administrative Kozare më datën 28.02.2018 ka debitorë për taksat dhe tarifatat vendore pa u likuiduar të ardhura të munguara në vlerën 11,716,416 lekë, nga e cila 33 subjekte biznesi në vlerën 990,342 lekë dhe 1065 fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës në vlerën 10,716,074 lekë.

Nuk kanë njoftuar familjarët nëpërmjet postës, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 71, të Udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

11. z.A. ■■■■■ D. ■■■■■, Administrator i Njesisë Administrative Perondi nga 03.02.2016 e në vazhdim.

12. z.L. ■■■■■ Sh. ■■■■■, Inspektor i taksapaguesve i Njesisë Administrative Perondi, nga 28.06.2016 e në vazhdim.

Nga mos kryerja e detyrave funksionale Njësia Administrative e Njësia Administrative **Perondi** më datën 28.02.2018 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar të ardhura të munguara në vlerën prej 29,063,634 lekë, nga e cila 14 subjekte biznesi në vlerën 315,048 lekë dhe 1807 fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës në vlerën 17,699,480 lekë, 227 persona nuk kanë paguar për 66.8 ha qiranë e tokës së pandarë në shumën 10,997,658 lekë.

Nuk kanë njoftuar familjarët nëpërmjet postës, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

**Për 2 punonjësit e Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit të Bashkisë Kuçovë si më poshtë:**

-Bazuar në ligjin nr.10279,datë 20.05.2010”Për kundravajtjet administrative” nenin 44-Përgjegjësia e punonjësit të organit administrative, ku parashikohet se: Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhet për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e masave disiplinore.

13. z.A. ■■■ D■■■, Kryeinspektor i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit (IMTV) emëruar me vendimin nr. 26, 12.11.2007 dhe vendimin nr.32, datë 01.11.2000 e në vazhdim.

14.z. R■■■■ B■■■■, Inspektor (IMTV) emëruar me Vendimin nr.27 26.11.2007 e në vazhdim.

**Për shkeljet e mëposhtme:**

-Nuk kanë nisur procedurat ligjore të vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të gjobës) të përcaktuara në nenet, 9, 22 dhe 30 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative".

-Nuk kanë kërkuar në Gjykatë, shndrimin në **titull ekzekutiv** të 32 vendimeve të kundërvajtjes me gjobë në vlerën 11,200,000 lekë, siç përcaktohet në nenin 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv,të ligjit nr.10279,datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative".

-Edhe pse për vitet 2016-2017 janë dhënë 32 Lejë ndërtimi, në subjektet private dhe po kaq me fondet shtetërore, u konstatua se punonjësit e IMTV:

a-nuk kanë hapur dosje për secilin subjekt, nuk ka marë zyrtarisht nga subjektet ndërtuese dokumentacionin teknik-ligjor dhe nuk ka pajisur zbatuesin e punimeve, (subjektet ndërtuese) me vërtetim për likuidimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1014" Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", ndryshuar me ligjin nr. 10,324, datë 23.09.2010.

b-nuk është zbatuar grafiku i përfundimit të objekteve, pasi në asnjë rast nuk është dorëzuar objekti dhe nuk është hartuar akt kolaudimi i objekteve, nga IMTV nuk janë zbatuar sanksione për dënim me gjobë apo anulimin e lejeve të ndërtimit,siç parashikohet në ligjin nr. 107/2014 datë 01.10.2014 i ndryshuar, neni 52 -Kundërvajtjet administrataive shkronja (dh) ku parashikohet se: Shkelja e afatit të fillimit punimeve apo përfundimit të punimeve , sipas nenit 40 të këtij ligji dënohen me gjobë nga 50,000-150,000 lekë.

15.F■■■■ P■■■■, me detyrë Drejtor i Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Kuçovë.

-Për mos llogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë për 9 subjekte të pajisur lejet e ndërtimit për 2 vitet 2016-2017,duke shkaktuar buxhetit të Bashkisë mungesë të ardhurash me dëm ekonomik në vlerën 1,339,750 lekë. Në kundërshtim me çmimet e përcaktuara në dy Udhëzimet e KM nr.4, datë 30.09.2015, "Për entin Kombëtar të Banesave për vitin 2015" dhe Udhëzimin e KM nr.3, datë 28.12.2016, "Për entin Kombëtar të Banesave për vitin 2016", nenin 46-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, të ligjit nr. 107/2014 datë 01.10.2014 i ndryshuar dhe nenin 27, të ligjit nr. 142/2015, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10 2006 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore" (Trajtuar më hollësisht në faqe 182-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Për periudhën nga 01.01.2015 deri më 31.12.2017 nuk ka marë masat e nevojshme për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje, nuk e njihte gjendjen dhe nuk bëri të mundur nxjerrjen e listave për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Duke mos zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, për objektet që legalizohen (Trajtuar më hollësisht në faqe 182-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.J■■■■ L■■■■, inspektor në IMTV Kuçovë ,në cilësinë e ish specialistit të projekteve në Drejtorinë e Planifikimit Territorit, i ngarkuar me mbajtjen e të dhënave për taksën ndikimit në infrastrukturë nga Aluizni.

-Pasi, për periudhën nga 01.01.2015 deri më 31.12.2017 nuk ka marë masat e nevojshme për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje.

Nuk e njihte gjendjen dhe nuk bëri të mundur nxjerrjen e listave për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke mos zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, për objektet që legalizohen *Trajtuar më hollësisht në faqe 182-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pai personat e më poshtëm nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

1. R. [REDAKTUAR] D. [REDAKTUAR], ish Agjent tatimor nga 04.04.2016 deri me 17.10.2017, Drejtor i komanduar nga 17.10.2017 e ne vazhdim, pasi ka punuar për një periudhë të shkurtër prej 2 muajsh në cilësinë e Drejtorit të të ardhurave.

2. B. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] Kryeinspektori i Policisë Bashkiake dhe 6 punonjësit e policisë Bashkiake respektivisht: V. [REDAKTUAR] D. [REDAKTUAR], B. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR], R. [REDAKTUAR] D. [REDAKTUAR], S. [REDAKTUAR] D. [REDAKTUAR], P. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR] dhe A. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR], shkeljet e konstatuara janë vetëm për mos arkëtimin e gjobave të vendosura prej tyre në shumën 60,000 lekë, prandaj nuk është rekomanduar masë.

3. G. [REDAKTUAR] Q. [REDAKTUAR], Drejtor i Drejtorisë Juridike,

*-16 punonjësit e mëposhtëm janë larguar për arsye të zbatimit reformës teritoriale dhe nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion si më poshtë:*

1. M. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR], ish kryetar i komunës Kozare,

2. Z. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR] ish kryetar i komunës Lumas,

3. R. [REDAKTUAR] B. [REDAKTUAR], ish Agjente tatimore

4. B. [REDAKTUAR] D. [REDAKTUAR], ish Përgjegjëse e Zyrës Financës ish Komuna Lumas, larguar jashtë Shqipërisë.

5. P. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR], me detyrë ish-Kryeinspektor i Taksave ish Komuna Lumas

6. G. [REDAKTUAR] Z. [REDAKTUAR], me detyrë ish-inspektor i Taksave ish Komuna Lumas

7. A. [REDAKTUAR] Q. [REDAKTUAR], me detyrë ish-inspektor i Taksave ish Komuna Lumas

8. F. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR] ish magazinier, ish komuna Lumas,

9. J. [REDAKTUAR] Q. [REDAKTUAR], ish arkëtar, ish komuna Lumas

10. I. [REDAKTUAR] Q. [REDAKTUAR], ish inspektor i pyjeve, ish komuna Lumas

11. V. [REDAKTUAR] Ç. [REDAKTUAR], ish inspektore taksave, ish komuna Lumas

12. I. [REDAKTUAR] Sh. [REDAKTUAR] ish inspektor i taksave, ish komuna Lumas

13. V. [REDAKTUAR] Q. [REDAKTUAR], ish inspektor i taksave, ish komuna Lumas

14. Xh. [REDAKTUAR] Q. [REDAKTUAR], arkëtar ish komuna Lumas.

15. B. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR], teknik ndërtimi ish komuna Lumas.

16. Z. [REDAKTUAR] F. [REDAKTUAR], inspektor ish komuna Lumas

17. D. [REDAKTUAR] G. [REDAKTUAR], ish Drejtor i Urbanistikës, punonjës i jashtëm.

#### **F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët do të jepet masë disiplinore për sa më sipër, Bashkia Kuçovë, Njësia e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

G. Ky auditim vlerësohet dobët nga Kryetari, pavarësisht se pa përfunduar procesi i auditimit, dy auditues janë shkëputur nga grupi i auditimit, njëri për arsye shëndetësore dhe tjetri për arsye të daljes në pension pleqërie. Shtuar edhe faktin që dy kryeaudituesit, përveç auditimit të Bashkisë Kuçovë kanë qenë me trajnim jashtë vendit apo janë angazhuar në auditime të tjera dhe me problemet në Departament.

**G.1. Për arsye të mos përmbushjes plotësisht të objektivave të auditimit, mos përcaktimi i saktë i dëmit apo mos efektivitetin ekonomik të shkaktuar në fushën e investimeve publike, gjatë muajit Shtator 2018, do të auditohet zbatimi i kontratave të punimeve në investimin me objekt "Rikualifikim urban i lagjes 11 janari, Kuçovë".**

Për këtë objekt është lidhur kontrata bazë me datë 23.06.2017 me vlerë të kontratës **144,379,557 lekë** me TVSH mes Autoriteti Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe bashkimit të operatorëve ekonomike "B [REDAKTUAR]" Shpk dhe "SH [REDAKTUAR]" Shpk, të përfaqësuar këta nga OE "B [REDAKTUAR]" Shpk. Sipas shkresës nr. 3662 prot., datë 13.11.2017 është lidhur kontrata shtesë me vlerë të kontratës shtesë 28,795,326 lekë pa TVSH e parashikuar për tu likuiduar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 60, datë 25.10.2017 respektivisht: në vitin 2017-vlera 14,405,000 lekë me TVSH, në vitin 2018-vlera 9,250,000 lekë me TVSH dhe në vitin 2019 - vlera 5,140,326 lekë.

Sipas shtesës së Programit të auditimit nr. 54/3, datë 19.03.2018, periudha audituese ishte përcaktuar deri më datën 30.03.2018, ndërkohë që kolaudimi i objektit "**Rikualifikim urban i lagjes 11 janari, Kuçovë**", është kryer me datë 05.04.2018 dhe punimet janë marrë në dorëzim më datën 09.04.2018, pra dosja teknike nuk ka qenë e plotë dhe në dispozicion të grupit të auditimit për tu audituar, duke mos përmbushur objektivat e programit të auditimit. Për këtë arsye investimi me objekt: "**Rikualifikim urban i lagjes 11 janari, Kuçovë**", do të auditohet gjatë muajit Shtator 2018, në lidhje me zbatimin e kontratës punimeve dhe projekt-preventivit sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të përcaktuara në tenderin e zhvilluar për këtë investim.

*Shënim:<sup>1</sup> Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi, nga ana e Bashkisë, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke e njoftuar me shkresë zyrtare KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**BUJAR LESKAJ**

**KRYETAR**